



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:239267

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05364682

C.nr.186/16

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, me bashkëpunëtoren profesionale Diellza Zeqiri Latifi në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.B nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.N.S, nga Prishtina, kundër të paditurës K... E... me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.B, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 18,784.70 €, të precizuar me parashtresën e dorëzuar në seancën e dt.06.02.2024, pas përfundimit të shqyrtimit kryesore publik të mbajtur më datë 06.02.2024, jashtë seance, me datën 21.02.2024 e mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.B nga Mitrovica, ashtu që DETYROHET e paditura K... E... me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 08.02.2016 në fshatin Shkabaj, Komuna e Prishtinës të i'a paguaj shumat dhe atë:

Në emër të dëmit jo material

- Për dhimbje fizike shumë prej ..... 3,500.00€
- Për frikën e pësuar shumë prej..... 3,500.00€
- Për shëmtim trupor shumë prej ..... 4,000.00€

Në emër të dëmit material

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej ..... 200.00€
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej..... 200.00€
- Në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej ..... 69.70€

Ashtu që shuma e tërësishme për të gjitha format e dëmit arrin vlerën prej 11,469.70€, me kamate prej 8%, e cila për dëmin jo material në shumë prej 11,000 € llogaritet dhe fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa që për dëmin material në shumë prej 469,70euro kamata llogaritet dhe fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së padisë me datën 17.05.2016, e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t'ia paguaj shumë të totale prej 1,073.00 € e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II.REFUZOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses E.B nga Mitrovica, mbi shumat e aprovuara si në pikën I të këtij aktgjykimi dhe atë në emër të dëmit jo material - për dhimbje fizike shumë prej 3,500 €, për frikën e përjetuar shumë prej 3,500 € si dhe kërkesa për kompensimin e rehabilitimit klimaterik në lartësi prej 300 euro.

A r s y e t i m

Paditësja E.B nga Mitrovica përmes të autorizuarit të saj av.B.S më dt.17.05.2016 ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate, ndaj të paditurës K... E... me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi material dhe jo material.

Në padi ka theksuar se më dt.08.02.2016 në fshatin Shkabaj, Komuna e Prishtinës është shkaktuar fatkeqësi komunikacioni, ku si pasagjere në automjetin nën A lëndime të rënda trupore ka pësuar tani paditësja E.B. Ka shtuar se deri te aksidenti ka ardhur me fajin e vozitësit të automjetit nën A, i cili në vendin e lartcekur për një moment humb kontrollin mbi automjetin e tij dhe kalon jashtë rrugës duke u rrokullisur, ku lëndime të rënda trupore pëson tani paditësja E.B.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.06.02.2024 paditësja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën për precizimin e padisë në aspektin objektiv, duke kërkuar nga e paditura kompensim dëmi material dhe jo material, ashtu që në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 7,000€, për frikën e pësuar shumë prej 7,000€, për shëmtim trupor shumë prej 4,000€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej 200€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 200€, në emër të rehabilitimit klimaterik shumë prej 300€, në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 69.70€, gjithsej në shumë prej 18,784.70euro, me kamat 12% duke filluar nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim, përkatësisht dt.10.03.2016 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, si dhe shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208€, emër të përfaqësimit në 2 seanca shumë prej nga 270€ (270x2=540.80€), për precizimin e padisë shumë prej 208 euro, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 26 euro, dhe në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës mjekësore shumë prej 300€.

Ndërsa që në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin ne tërësi pranë deklarimeve të gjertanishme, ashtu që sa i përket bazës juridike e njëjta nuk është kontestuese ne mes te palëve ndërgjyqëse por vetëm lartësia e saj. Ka shtuar se në bazë të ekspertizës mjekësore janë konstatuar lëndimet që ka pësuar paditësja, ku kemi të bëjmë me lëndime të rënda trupore si dhe shëmtim të shkallës së mesme, andaj ka kërkuar nga gjykata të marr parasysh sidomos shëmtimin e paditëses e cila është e moshës së re dhe ndikimin që ka tek gjinia femërore, duke theksuar se precizimi i padisë është në harmoni me lëndimet e pësuar te paditëses, si dhe me praktikën gjyqësore, andaj ka kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta aprovoj të bazuar, po ashtu ta aprovoj kamatën sipas mendimit juridike të dhënë nga GJS, si dhe shpenzimet e procedurës të cilat kanë qenë të domosdoshme për mbarëvajtjen e kësaj procedure.

E paditura K... E... me seli në Prishtinë përmes të autorizuarit të saj në përgjigjen në padi të paraqitur pranë kësaj gjykate, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por e konteston lartësinë e shumës së kërkesëpadisë të cilën e ka kërkuar paditësja. E njëjta në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk kanë vërejtje në ekspertizat mjekësore dhe nuk kërkojnë sqarime nga ekspertët. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se qëndrojnë mbrapa përgjigjes në padi dhe deklarimeve në seancën gjyqësore, nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë por lartësia e saj. E paditura e konteston padinë dhe precizimin e saj, sa i përket shumave të kërkuara duke theksuar se të njëjtat janë të pa bazuara, ne kundërshtim me lëndimet e pësuar, pasojat e mbetura tek paditësja ku me ekspertizë mjekësore lëndimet janë konstatuar të rënda, por pa invaliditet, andaj konsiderojnë se shumata e kërkuara për dhimbje fizike dhe frikë janë tepër të larta dhe në kundërshtim me nenin 183 par.2 të LMD-së, praktikën gjyqësore, si dhe se fundi udhëzuesin e GJS, ku paditësja ka kërkuar sikur të kishte lëndime tejet të rënda me invaliditet mbi 60%, e ne rastin konkret invaliditet nuk ka,

ndërsa sa i përket demit material kanë kërkuar nga gjykata që të aprovoj shumat të cilat janë të argumentuara me fatura, në të kundërtën ta refuzoj kërkesëpadinë, e po ashtu lidhur me kamatën e precizuar nga data e paraqitjes së kërkesës, të njëjtën e kanë kundërshtuar duke theksuar se e paditura prej momentin të paraqitjes së demit e deri në shqyrtimin gjyqësor, vazhdimisht i ka ofruar mundësinë e arritjes së një pajtimi gjyqësor apo jashtëgjyqësor, por të njëjtat shuma nuk i kanë pranuar, andaj i kanë propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes për kamatën ta gjykojë nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit me kamate ligjore sepse e paditura ka përmbushur obligimet e saj sipas LSDA-së.

*Procedura e provave dhe gjendja faktike e vërtetuar*

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Raporti i aksidentit i datës 08.02.2016, me skicën e vendit të ngjarjes, dokumentet mjekësore në emër të paditëses, të përfshira në ekspertizën mjekësore, si dhe faturat-kuponët, kërkesa për dëmtshpërblim e paditëses drejtuar të paditurës me dt.10.03.2016, njoftimi i të paditurës dt.15.03.2016, dy njoftime të datës 07.04.2016, njoftimi përmes emailit i dt.31.03.2022, si dhe ekspertizat mjekësore të eksperteve M.H dhe Sh.H të dt 08.08.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (tutje referuar si: LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*Faktet e vërtetuara dhe vendosja në lidhje me pjesën e aprovuar:*

Në mes palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, andaj edhe gjykata nuk ka nxjerrë prova për të konstatuar faktet jokontestueses në mes të palëve.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, si dhe për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditëses, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga eksperti psikiatër Dr.Sh.H, dhe ekspertizën mjekësore nga eksperti ortoped Dr. M.H.

*Përmes raportit të ekspertit psikiatër u vërtetuan faktet si në vijim;*

Se paditësja, nga aksidenti i komunikacionit të datës 08.02.2016, ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej 1-2 sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar për rreth 15 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar ka përjetuar për rreth 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe për një muaj tjetër vijues.

*Përmes raportit të ekspertit ortoped, gjykata vërtetoi faktet si në vijim;*

Paditësja në aksidentin e komunikacionit të datës 08.02.2016 ka pësuar plagë prerëse – shkyese në rrënjën e hundës, plagë prerëse shkyese në të dy gjunjët, ndrydhje koke, qafe, shpine. Ku lëndimet janë shkaktuar nga rënia, goditja në sipërfaqe të fortë, si pasojë e aksidentit të trafikut dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, ku gjatë mjekimit dhe rehabilitimit të njëjta ka qenë e shtrirë në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale në Prishtinë dhe si rrjedhojë e këtyre lëndimeve, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 30 minuta, dhimbje me intensitet të lartë 2 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm 22 ditë dhe me intensitet të ulët ka edhe sot e kësaj dite, posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike.

E njëjta ka shëmtim trupor në shkallë të mesme, për shkak të vrragave të shumta për shkak të plagëve shkyese – prerëse në rrënjën e hundës, buzë dhe të dy gjunjët, të dukshme tërë kohën, e disa kohë pas kohe, si dhe ndikimin që ka ky shëmtim në përjetimet emocionale dhe stigmatizim sa herë që del dhe ekspozohet në shoqëri, duke marrë parasysh edhe gjininë e paditëses.

Gjithashtu, për paditësen ndihma nga personi tjetër ka qenë e nevojshme për 22 ditë e cila ka nënkuptuar ndihmë mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga personat tjerë, e cila ndihmë i është ofruar personit të lënduar dhe i ka mundësuar plotësimin e nevojave biologjike siç janë: veshmbathja, higjiena personale, ushqimi, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, lëvizja me mjete ndihmëse ose pa to, pasi këto nevoja nuk ka mundur t'i plotësojë vetë si pasojë e paaftësisë fillimisht të plotë dhe pastaj të pjesshme e shkaktuar nga lëndimet trupore.

Lidhur me ushqimin e përforcuar, që ka qenë i nevojshëm për 25 ditë, e i cili ka nënkuptuar ushqim të pasur me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatik.

Dhe rehabilitimi fiziatrik në kohëzgjatje prej 15 ditë, i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyjat e qafës, boshtit kurrizor, si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e shtangimit të zhvilluar në nyje për shkak të lëndimit.

Gjykata, ekspertizat e ekspertëve mjekësor nga lëmia e psikiatrisë dhe ortopedisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu të punuara sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna të arsyetuara lidhur me natyrën e lëndimeve dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve trupore, përkatësisht frikës së përjetuar si pasojë e aksidentit të trafikut, gjykata ua fali besimin e plotë me rastin e vendosjes së kësaj çështje juridiko-civile.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata konform nenit 159 par. 1 të LMD-së, në të cilin përcaktohet se “*1. Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit*”, ndërsa në nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*” dhe në nenin 136 të LMD-së, në të cilin përcaktohet se “*Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, vlerësoi se e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditëses me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditëses t’ia kompensoi dëmin me që shkaktuesi i dëmit ka lidhur kontratë me të paditurën, dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë TPL (Sigurimit të detyrueshëm për palët e treta) konform nenit 159 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, gjykata u lëshua në vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë dhe atë lidhur me kërkesën që ka të bëjë me dëmin jo-material të paditëses, gjykata fillimisht mori për bazë dispozitën e nenit 183 par. 1 të LMD-së, përcaktohet se “*Për dhembjet e pësuarat fizike, për dhembjet e pësuarat shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material*”, dhe gjeti se gjendja faktike është në përputhje me gjendjen juridike si më lartë, andaj gjykata vlerëson se gjykimi i shumës në emër të dëmit jomaterial për paditësen dhe atë,

në emër të dhimbjeve fizike (trupore) shumë prej 3,500.00€, në emër të frikës së përjetuar për të gjitha kategoritë e saj shumë prej 3,500.00€, dhe për shëmtim trupor shumë prej 4,000.00 euro, duke pasur parasysh gjininë, si dhe shëmtimin trupor të pësuar, i cili shëmtim është në shkallë të mesme, për shkak të vragave të shumta për shkak të plagëve shkyese – prerëse në rrënjën e hundës, buzë dhe të dy gjunjët, të dukshme tërë kohën, e disa kohë pas kohe, si dhe ndikimin që ka ky shëmtim në përjetimet emocionale dhe stigmatizim sa herë që del dhe ekspozohet në shoqëri, andaj mbi bazën e mësipërme, gjatë vlerësimit se lartësia e shumave në të holla në emër të kompensimit të dëmit jo material, do t'i mundësoj paditëses satisfaksion që ajo të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar.

Sa i përket lartësisë së kërkesës për kompensimin e dëmit material, ndihma nga personi tjetër, ushqimi i përforcuar dhe shpenzimeve të mjekimit, gjykata pasi që nëpërmjet ekspertizave mjekësore konstatoj nevojën dhe kohëzgjatjen për ndihmë nga personi tjetër, dhe atë për 22 ditë të nevojës së kësaj ndihme, cila ka nënkuptuar ndihmë mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga personat tjerë, e cila ndihmë i është ofruar personit të lënduar dhe i ka mundësuar plotësimin e nevojave biologjike siç janë: veshmbathja, higjiena personale, ushqimi, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrolli sistematik për të cilat ka pasur nevojë dhe nuk ka mundur ti plotësoj vet si pasojë e paaftësisë fillimisht të plotë e pastaj të pjesshme e shkaktuar nga lëndimet e pësuar në aksident, për çka edhe gjykata e ka aprovuar shumë prej 200.00 euro. Lidhur me ushqimin e përforcuar, që ka qenë i nevojshëm për 25 ditë, e i cili ka nënkuptuar ushqim të pasur me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngritjen dhe sanimin e lëndimit, si dhe reaksionit post traumatik për çka edhe gjykata e ka aprovuar shumë prej 200.00 euro.

Si dhe mbi bazën e kuponëve fiskal të dt.21.03.2016, 21.03.2016, 14.03.2016, 29.02.2016, 15.02.2016, 13.02.2016, 01.03.2016 dhe 08.03.2016 i njohu paditëses shpenzimet e mjekimit në lartësi prej 69.70 euro, edhe pse sipas llogarisë së gjykatës vlera e këtyre kuponëve fiskal pas mbledhjes së tyre është 84.70 euro, mirëpo duke pas parasysh parimin e procedurës kontestimore që gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi lidhur me këtë kërkesë të palës paditëse, e po ashtu edhe në bazë të ekspertizës mjekësore është konstatuar se të gjitha shpenzimet e prezantuara në shkresat e lëndës i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Gjykata vlerëson se shumat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që lidhen me dëmin material, janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, janë në përputhje me nenin 169 par. 3 të LMD-së ku thuhet se: *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumë përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”*, e në lidhje me nenin 179 par. 1 të LMD-së, nga e cila dispozitë rrjedh se kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë që të shpërblej shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, andaj gjykata me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit material, si dhe në lidhje me shumë kompensimit të këtij dëmi, gjeti se shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë satisfaksion real për paditësit, si dhe mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore.

*Vendimi në lidhje me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, kamatën dhe shpenzimet e procedurës;*

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin jo material në emër të dhimbjeve fizike, si dhe për frikën e pësuar për paditësen, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, gjegjësisht shuma mbi 3,500.00€ në emër të dhimbjeve fizike, si dhe shuma mbi 3,500.00€ në emër të frikë së përjetuar, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin të cilit i shërben ky shpërblim, ndërsa ka refuzuar në tërësi kërkesën për kompensimin e dëmit material në emër të rehabilitim klimaterik në shumë prej 300.00 euro, për shkak të mungesës së provave.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, gjykata me kërkesën e paditëses dhe në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroj të paditurën që paditëses në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën në 8 % vjetore, ndërsa rrjedhjen e saj lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial gjykata e caktoi që nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa që lidhur me kompensimin e dëmit material, nga dita e parashtrimit të padisë, përkatësisht nga data 17.05.2016, gjithnjë duke iu referuar edhe qëndrimin të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës, e cila në vendimet e saj parashikon që rrjedhja e kamatëvonesës lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial caktohet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa që lidhur me kompensimin e dëmit material, nga dita e parashtrimit të padisë. Ndërsa që refuzoi kërkesën e paditëses që shumat e dëmit jo material dhe material e paditura t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 12%, duke llogaritur nga data 10.03.2016 (data e paraqitjes së kërkesës për kompensim tek e paditura), pasi që nga shkresat e lëndës gjykata nuk ka arritur të vërtetojë se e paditura është vonuar në përgjigjen e saj lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, përkatësisht paditësja nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e saj që kamata të rrjedh nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim tek e paditura.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 452 par. 1 të LPK-së, ngase paditësja ka fituar procesin kontestimor dhe e njëjta i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, andaj gjykata të njëjtës ia njohu shpenzimet dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208€, në emër të përfaqësimit në 2 seanca shumë prej nga 270€ (270x2=540€) dhe në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës mjekësore shumë prej 300€, dhe për taksë gjyqësore shumë prej 25€, në shumë totale prej 1,073.00€, ndërsa refuzoj kërkesën për kompensimin e shpenzimeve në emër të parashtrësës për precizim të lartësisë së kërkesëpadisë shumë prej 208.00 euro, ngase procedura kontestimore duhet të përfundojë me sa më pak shpenzime, e që kjo përcaktohet në parimin bazë të kësaj procedure, parimin e ekonomizimit të procedurës, e po ashtu precizimi i kërkesëpadisë nuk ka qenë i domosdoshëm të bëhet me parashtrësë dhe se i njëjti ka mundur të bëhet gjatë shqyrtimit kryesor pa u shkaktuar shpenzime shtesë.

Andaj, gjykata duke u bazuar në faktet e përshkruara, provat e administruara dhe bazën ligjore të lartpërmendur, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.186/2016, datë 21.02.2024

Gj y q t a r i  
Izet Gërguri

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e nesërme e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit e përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.